



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar rre dt.	11.05.2021
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-150

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Naser Bajraktari

Prizren, më 11.05.2021

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 178 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 07-2018 të datës 09.02.2018, për Zgjedhjet e Studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren

Neni 1

Miratohet propozimi i Komisionit për plotësimin dhe ndryshimin Rregullores me nr. prot. 07-2018 të datës 09.02.2018, për Zgjedhjet e Studentëve të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Neni 2

Neni 5 pika 1 e Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

Numri i tërësishëm i anëtarëve të Parlamentit të Studentëve dhe i Këshillave të Studentëve është i rregulluar me dispozitet e nenit 155 pika 2 respektivisht neni 156 pika 2 e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

NENI 3

Neni 12 pika 3 e Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të dërgojë kërkesë me shkrim, për të marrë emrat e nominuar nga organizatat nominuese sipas paragrafit 2 të këtij neni, që në ditën e shpalljes së zgjedhjeve. Kjo shkresë duhet të ju dërgohet së bashku me një ftesë për mbledhjen konstituive. Nominimet duhet të dorëzohen me shkrim te Kryesuesi i Këshillit Drejtues, më së voni një (1) ditë para mbajtjes së mbledhjes konstituive. Nominimet e vonuara nuk do të bëjnë pezullim të procedurave.

NENI 4

Neni 30 pika e 1 e Rregullores ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

Qendrat e vendotimeve në të gjitha njësitë akademike hapen në orë 08:00 dhe mbyllen në orën 19:00, përjashtimisht nga kjo, nëse në kohën e mbylljes së vendotimeve ka radhë të votuesve, atëherë koha e mbylljes së vendotimeve zgjatet deri në votimin e studentit të fundit.

NENI 4

Ndryshime dhe riformulime të tjera:

- Të gjitha shkurtesat UPZ brenda në tekstin e Rregullores bazë zëvendësohen me shkurtesën Universitet.
- Largohet fjala “indeks” në të gjitha nenet e Rregullores bazë.

NENI 6

Ky plotesim – ndryshim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prof. Asoc. Dr. Naser Bajraktari


Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Njësive Akademike;
- Zyrës Ligjore;
- Zyrës së Personelit;
- Arkivit.